

**Vendim nr. 159 datë 10.07.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                 |           |
|-----------------|-----------|
| Elsa Toska,     | Kryesuese |
| Sonila Bejtja,  | Anëtare   |
| Genti Ibrahimi, | Anëtar    |

në datën 10.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (N) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** NDUE PJETRA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 216, datë 09.10.2019 të Gjykatës Administrative së Apelit; nr. 00-2023-261, datë 26.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ndue Pjetra ka paraqitur kandidaturën e tij për pozicionin e lirë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative civile dhe penale, të shpallur në bazë të vendimeve nr.108, datë 09.07.2019, nr.109, datë 09.07.2019 dhe nr.110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”.

2. Me vendimin nr.159, datë 11.09.2019, KLGJ-ja ka vendosur: *“Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. Ndue Pjetra nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, Vendimin nr.109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor [...]”,* pasi ai nuk plotësonte kushtin e kandidimit lidhur me mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi, sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr.96/2016). Kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.216, datë 09.10.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit për të gjitha pretendimet e tij, me arsyetimin se ai nuk ka provuar përpara saj se i është dhënë një gradë shkencore në drejtësi nga një Institucion i Arsimit të Lartë (IAL), i licencuar. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2023-261, datë 26.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligjit nr.49/2012).

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 18.04.2023 me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 216, datë 09.10.2019 të Gjykatës Administrative së Apelit dhe nr. 00-2023-261, datë 26.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## II

### **Pretendimet e kërkuessit**

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi vendimet e KLGJ-së dhe të gjykatave janë arbitrare, të pabazuara ligjërisht, të paarsyetuara dhe e kanë privuar atë padrejtësisht nga vijimi i procedurave për zgjedhjen si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si kandidat nga radhët e juristëve të spikatur. Sipas tij, KLGJ-ja ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar konceptin e gradës shkencore. Interpretimi i saj se si gradë shkencore konsiderohet doktoratura, në thelb, nuk qëndron, pasi nuk ka asnjë bazë ligjore për të mos e kualifikuar masterin shkencor në drejtësi si të tillë. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka analizuar provat, duke u shprehur për pretendimet për skualifikimin e tij në bazë të një kriteri të ri, i cili nuk ka qenë bërë i ditur për aplikantët në vendimet e KLGJ-së. Nenet e ligjit nr. 9741/2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 9741/2007), të cituara nga kjo gjykatë nuk përkojnë me objektin e kërimit dhe pretendimet e tij, duke i mohuar të drejtën për një vendim të arsytuar. Edhe Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit dhe që kërkonin një përgjigje përfundimtare, por është mjaftuar me citime të përgjithshme. Vendimi i saj është kontradiktor, pasi ndërkohë që në një pjesë të tij citon se ai plotëson kushtin e kandidimit, në përfundim vendos mospranimin. Po sipas kërkuessit, në thelb të kërtimeve të tij qëndronte interpretimi i konceptit “gradë shkencore” në përputhje me nenin 136 të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, pasi një përkufizim shterues i tij nuk rezulton në asnjë ligj ose akt nënligjor.

### **III**

#### **Vlerësimi i Kolegjit**

##### *A. Për legjitimitimin e kërkuessit*

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji thekson se kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kolegji vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

10. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuksi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuksi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, kërkuksi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuksi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 26.01.2023 ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur, fillimisht, në Gjykatë në datën 06.04.2023 dhe, pas plotësimit të tij, është regjistruar në datën 18.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i përket legjitimit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet e gjykatave, në përmbajtje të tij kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për vendimin e KLGJ-së. Ai ka pretenduar se vendimet e KLGJ-së dhe të gjykatave i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë Kolegji vlerëson t’i analizojë ato në vijim.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë*

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e KLGJ-së dhe të gjykatave janë arbitrare, të pabazuara ligjërisht, të paarsyetuara dhe e kanë privuar atë padrejtësisht nga vijimi i procedurave për zgjedhjen si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si kandidat nga radhët e juristëve të spikatur. Sipas tij, KLGJ-ja ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar konceptin e gradës shkencore; Gjykata Administrative e Apelit nuk ka analizuar provat, duke u shprehur për pretendimet për skualifikimin e tij në bazë të një kriteri të ri, i cili nuk ka qenë bërë i ditur për aplikantët në vendimet e KLGJ-së; Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit dhe që kërkonin një përgjigje përfundimtare, por është mjaftuar me citime të përgjithshme. Vendimi i saj është kontradiktor, pasi ndërkohë që në një pjesë të tij citon se ai plotëson kushtin e kandidimit, në përfundim vendos mospranimin e rekursit.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë

dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

16. Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjyqimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po kështu, Kolegji thekson zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur kandidaturën e tij për pozicionin e lirë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative, civile dhe penale, sipas vendimeve nr. 108, datë 09.07.2019, nr.109, datë 09.07.2019 dhe nr. 110, datë 09.07.2019 të

KLGGJ-së. Kjo e fundit, me vendimin nr. 159, datë 11.09.2019, ka vendosur skualifikimin dhe përjashtimin tij nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, pasi nuk plotësonte kushtin e kandidimit lidhur me mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi, duke arsyetuar se edhe në shpjegimet e tij në rrugë elektronike kërkuesi ka deklaruar se nuk është mbajtës i titullit “Master i Shkencave”, “Doktor” ose “Profesor i Asociuar” në drejtësi, pasi ka kryer studimet sipas modelit të vjetër 4-vjeçar. Ai ka theksuar se gjatë karrierës 15-vjeçare ka botuar një sërë punimesh shkencore të materializuara në libra, të cilat i ka vënë në dispozicion në momentin e kandidimit. Po sipas KLGGJ-së, gjatë procedurës së verifikimit, megjithëse kërkuesi është ftuar për të paraqitur dokumentacionin mbështetës, nuk ka paraqitur asnjë akt për të vërtetuar mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi. Fakti që ai ka kryer studimet në drejtësi sipas modelit 4-vjeçar ose fakti që ai ka botuar një sërë librash, nuk e përjashton atë nga detyrimi kushtetues dhe ligjor për të provuar mbajtjen e gradës shkencore në drejtësi.

20. Ky vendim është ankimuar nga kërkuesi në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e padisë për të gjitha pretendimet e tij. Sipas kësaj gjykate, në ligjin nr. 96/2016 nuk përcaktohet se cilën gradë shkencore duhet të ketë kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, kështu që në kushtet kur kualifikimet universitare dhe pasuniversitare certifikohen nga IAL-të, gjykata ka analizuar dispozitat e ligjeve nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 80/2015*) dhe ligjit nr. 9741/2007 (aktualisht i shfuqizuar nga ligji nr. 80/2015), duke qenë se diploma e paraqitur nga kërkuesi është lëshuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015. Gjykata ka arsyetuar se kërkuesi nuk ka mundur të paraqesë as para KLGGJ-së dhe as para saj një diplomë me të cilën t’i ishte dhënë një gradë shkencore nga IAL-të; ai ka deklaruar se nuk është mbajtës i titullit “Master i Shkencave”, “Doktor i Shkencave” ose “Profesor i Asociuar” në drejtësi, pasi ai ka kryer studimet sipas modelit të vjetër 4-vjeçar, por ka pretenduar se efektivisht e zotëron masterin shkencor dhe këtë e interpreton si gradë shkencore në drejtësi. Në rrethanat kur kërkuesi nuk ka provuar përpara gjykatës se ka ndjekur studimet e ciklit të tretë, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se me diplomën e paraqitur nga kërkuesi, ky i fundit nuk ka fituar ndonjë gradë shkencore, për pasojë nuk plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për të kandiduar për gjyqtar të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur. Po sipas kësaj gjykate,

studimet e ndjekura më parë nga kërkuesi, të certifikuara me diplomën nr.7666, datë 03.02.2003 të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, mund të ekuivalentohen me diplomën “Master i Shkencave” në kuptim të nenit 124, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 80/2015. Ndërkohë që, diploma nr. 807/B, datë 26.11.2005, e lëshuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, nuk i mundësonte kërkuesit fitimin e një grade shkencore, pasi me anë të kësaj diplome ai kishte fituar titullin “jurist”(shih vendimin nr.216, datë 09.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqet 11 dhe 13, paragrafët 9, 10 dhe 11).

21. Ndaj vendimit të mësipërm kërkuesi ka ushtruar rekurs, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin. Ky kolegji ka arsyetuar, ndër të tjera, se Gjykata Administrative e Apelit ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe përfundimi i arritur prej saj është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes përmes sqarimit të plotë të rrethanave e të fakteve lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, si dhe përmes cilësimit të saktë të fakteve dhe veprimeve, në analizë të hollësishme të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, si dhe të ligjit nr. 80/2015, që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim (shih vendimin nr. 00-2023-261, datë 26.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 7, paragrafi 10).

22. Në analizë të vendimmarrjeve të KLGJ-së dhe të gjykatave, Kolegji konstaton se kërkuesi ka aplikuar për pozicionin e lirë të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative civile dhe penale, ku, sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, një ndër kriteret e përzgjedhjes për këtë pozicion është edhe pasja e gradës shkencore në drejtësi. Kërkuesi është skualifikuar nga KLGJ-ja, e cila, në interpretim të këtyre dispozitave, ka vlerësuar se ai nuk e plotëson këtë kriter. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, ai e ka kundërshtuar gjyqësisht atë në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e ka gjetur të drejtë interpretimin e bërë nga KLGJ-ja. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se KLGJ-ja dhe gjykata administrative e apelit kanë zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin e zbatueshëm.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm

dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Sipas Gjykatës, ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore, raste në të cilat Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata, duke ndjekur edhe qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vëren se, në thelb, pretendimi i kërkuarit lidhet me interpretimin e konceptit “gradë shkencore”, të parashikuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, kriter ky që duhet të përmbushet nga individët që synojnë të kandidojnë për pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

26. Nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe në analizë të vendimmarrjeve të KLGJ-së dhe të gjykatave, Kolegji vëren se interpretimi që ato i kanë bërë këtij koncepti kushtetues dhe ligjor nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat

kanë dhënë përgjigje të argumentuar në lidhje me to, në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit.

27. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se Gjykata e Lartë është kontradiktore në vendimin e saj, pasi në një pjesë të vendimit citon se kërkuari plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, Kolegji çmon se gabimi material në pikën 2 të vendimit të kësaj gjykate, ku është parashtruar vendimmarrja e KLGJ-së, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

28. Për më tepër, Kolegji vëren se në tërësinë e tyre vendimet objekt shqyrtimi paraqiten të rregullta në formë dhe nuk rezultojnë të kenë paqartësi. Pjesët hyrëse, ato arsyetuese dhe dispozitivët e vendimeve të dhëna në çështjen e kërkuarit vlerësohen në harmoni me njëra-tjetrën. Po kështu, vendimet nuk shfaqin pamjaftueshmëri lidhur me thelbin e pretendimeve të kërkuarit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, është haptazi i pabazuar.

29. Në kushtet kur Kolegji vlerëson se ky kriter paraprak nuk plotësohet dhe pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.